

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

Në mbështetje të Kodit të Punës, ligjit " Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive " i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 3, dt. 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infekzionit të shkaktuar nga COVID-19" i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 193 "Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, V.K.M. nr. 243, dt. 24.03.2020 " Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore ", Udhëzuesit për " Rekomandime të përgjithshme ndaj subjekteve të biznesit që lejohen të zhvillojnë aktivitetin në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVI-19 ", udhëzimet e vazhdueshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë,

Operatori: Ervis Cina ka marrë masat e mëposhtme:

1. Të sigurohen në mënyrë të vazhdueshme për punonjësit, elementet e higjenës dhe mjetet e mbrojtjes personale, të cilat shërbejnë si barrierë fizike për minimizimin e transmetimit të infekzionit Covid-19, ku përfshihen:

- a. Sapun i duarve;
- b. Dezinfektant me bazë alkooli me të paktën 60% alkool;
- c. Letër për pastrimin e duarve ose peshqir me një përdorim;
- d. Letër dhe dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve;
- e. Kosha të mbyllur për eliminimin e mbetjeve;
- f. Maska (maskat mund të janë edhe prej cope dhe të ndërrohen çdo ditë);
- g. Doreza.

Të garantohet përdorimi nga ana e stafit, i maskave, dorezave dhe dezinfektuesit dhe përdorimi i tyre sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Rregullat që duhet të ndiqen:

- Të gjithë punonjësit duhet të janë të pastër dhe higjenikë;
- Sipërfaqet (psh të tavolinave etj) dhe objektet(telefona, tastierë etj) duhet të dezinfektohen rregullisht; - Dizinfektantët e duarve duhet të vendosen në ambjentet e punës dhe të sigurohet rimbushja e vazhdueshme e tyre;
- Të vendosen postera që inkurajojnë higjenën e duarve në hyrje të vendit të punës dhe në zona të tjera të vendit të punës ku janë të dukshme;
- Të vendosen postera për higjenën e frysëmarrjes;
- Të siguroheni që stafi dhe klientët kanë akses në vende ku mund të lahen duart me ujë dhe sapun;
- Të sigurohet mbajtja e distancës prej të paktën 2 metra;

Adresa: Rruga "Llazar Gjermwni" 01840037; Nd81; H.1; Kolonjw; Gorre; 9019; Lushnje.

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

- Të respektohen masat e distancimit social sipas planit të veçantë të afishuar në ambientet e kompanisë;
- Të shmanget prekja e syve, hundës dhe gojës;
- Të praktikohet higjena respiratore, kollitjes dhe tështitjes duke përdorur vënien e gropëzës së brryli përpara gojës dhe hundës;
- Punonjësit duhet të lajnë duart dhe të përdorin dezinfektantin kur i kanë të ndotura si dhe pas heqjes së maskës dhe dorezave;
- Nuk duhet të përdoret shtrëngimi i duarve apo përqafimi midis punonjësve për tu përshëndetur; të shmanget kontakti fizik gjatë përshëndetjeve.

2. Ndalohet përdorimi i mjeteve të njëri-tjetrit nga punonjësit si dhe qëndrimi në postin e punës së njëri-tjetrit. Punonjësit nuk duhet të përdorin pajisjet e mëposhtme që i takojnë një punonjësi tjetër;

- a. Telefonat;
- b. Kompjuterin;
- c. Tavolina;
- d. Telekomandat;
- e. Mjetet e punës në terren;
- f. çdo pajisje tjetër

Ato duhet të pastrohen dhe dezinfektohen para dhe pas përdorimit. Të sigurohen pastruesit e duhur në mënyrë që sipërfaqet e përdorura zakonisht të mund të fshihen nga punonjësit para çdo përdorimi. Nëse sipërfaqet janë të ndotura, ato duhet të pastrohen duke përdorur një pastrues ose sapun dhe ujë para dezinfektimit.

3. Nëse një nga punonjësit ka ose ka pasur kontakt të ngushtë me një person pozitiv me Covid 19, duhet të qëndrojë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë mjekun e ndërmarrjes dhe administratorin, i cili më pas njofton NJVKSH-në përkatëse.

4. Punonjësit që kanë shenja klinike të qëndrojnë në shtëpi, të vetëizolohen dhe të monitorojnë shenjat klinike dhe për çdo shqetësim të njoftojnë 127 dhe mjekun e familjes si dhe të njoftojnë mjekun e ndërmarrjes dhe administratorin.

5. Nëse punonjësi shfaq shenja klinike, Administratori do të largojë nga puna punonjësin, për të qëndruar në shtëpi, dhe duhet të njoftojë brenda 24 orëve NJVKSH-në dhe ISHP-në.

6. Nëse konstatohet një rast i dyshuar me Covid 19 nga mjeku i ndërmarrjes, duhet të njoftohet menjëherë NJVKSH dhe ISHP.

7. Punonjësit të cilët kanë ftohje apo temperaturë të lehtë(37.3 ose më shumë) duhet të qëndrojnë në shtëpi. Ata duhet të qëndrojnë në shtëpi gjithashtu(apo të punojnë nga shtëpia) nëse duhet të

Adresa: Rruga “Llazar Gjermwni” 01840037; Nd81; H.1; Kolonjw; Gorre; 9019; Lushnje.

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

marrin mjekime të lehta si paracetomol/acetaminophen, ose aspirin, të cilat mund të fshehin simptomat e infektimit.

8. Të caktohet një mjedis i izoluar për një punonjës, i cili mund të shfaqë shenja klinike të sëmundjes dhe më pas të lajmërohet 127-ta dhe NJVKSH-ja përkatëse.

9. Lidhur me shërbimet që ofrohen në mjedise të mbyllura, anëtarët e stafit që shërbejnë në marrëdhëniet me klientët, duhet të respektojnë me rigorozitet masat profilaktike të rekomanduara (maska, doreza, mjete higjene dhe desinfektuesit e mjedisit etj.), duke respektuar distancat minimale të qëndrimit prej jo më pak se 2 metra largësi nga kolegët dhe klientët, dhe jo më shumë se një klient në ambjent;

10. Në njësitë e shitjes të vendoset xhami-mbrojtës Klient-Shitës dhe elementët e distancimit fizik me shenja vizuale të dukshme në sipërfaqen e dyshemësë.

11. Drejtuesit e njësive organizative të marrin masa për reduktimin e fluksit të klientëve në shërbimet për publikun, duke rekomanduar klientët të përdorin alternativa të tjera komunikimi. Për të evitar radhët dhe kontaktet pranë njesive tona në lidhje me shërbimet, të përdoren pikat e easy pay, bankë, western union. Shërbimet ndaj pajtimarëve të kryhen on-line për sa është e mundur, me qëllim minimizimin e kontakteve me punëmarrësit e shoqërisë.

12. Të përdoren kamerat e survejimit për të vëzhguar nëse masat e përcaktuara të higjenës dhe kujdesit zbatohen me saktësi.

13. Të shqyrtohet mundësia e përdorimit të sistemit të ventilimit me qëllim:

a. Rritjen e nivelit të ventilimit;

b. Rritjen e përqindjes së ajrit në natyrë që qarkullon në sistem;

14. Të kryhet dezinfektimi i vazhdueshëm i të gjitha ambjenteve në të cilat zhvillon veprimtarinë shoqëria Itcom shpk, mjediset e zyrave dhe njësi shitje.

15. Të kryhet dezinfektimi i vazhdueshëm i të gjitha automjeteve që përdoren nga punonjësit e shoqërisë Itcom.

16. Të kryhet dezinfektimi i vazhdueshëm i të gjitha pajisjeve që përdoren nga punonjësit e shoqërisë Itcom

17. Të pezullohen procedurat e rekrutimit të personelit, trajnime dhe specializime kolektive ne mjediset e shoqërisë. Në rastet e nevojshme për trajnim, të përdoren metodat e komunikimit elektronik.

18. Të hartohet politika e brendshme për punën nga shtëpia dhe të përcaktohen punonjësit që do të kryejnë punën nga shtëpia; Administratori do të përcaktojë me grafik punëmarrësit që do të kryejnë detyrën nga shtëpia.

Adresa: Rruga “Llazar Gjermwni” 01840037; Nd81; H.1; Kolonjw; Gorre; 9019; Lushnje.

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

19.Në kuadër të këtij detyrimi, të identifikohen personat që mund të jenë në rrezik duke i mbështetur ata, pa frymëzuar diskriminim në vendin e punës (psh diabet, sëmundje të zemrës dhe mushkërive, mosha e madhe etj) të cilëve t'iu rekomandohet qëndrimi në shtëpi.

- a. Të hartohet grafiku i ndarjes së punonjësve në zyrë për të respektuar kriterin e distancës prej 2 metra nga njëri-tjetri;
- b. Të hartohet një plan për distancimin social me masa konkrete dhe të qarta, që kanë si synim minimizimin në maksimum të kontaktit fizik midis punonjësve dhe respektimin e distancimit;
- c. Të hartohej rekomandime të përgjithshme për klientët të cilët vizitojnë njësitë tregtare të ITCom;

20. Zbatimi i këtij vendimi siguron:

- a. Reduktimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve;
- b. Sigurimin e një ambienti të shëndetshëm në punë;
- c. Vijimësinë normale të aktivitetit të biznesit;

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

* Të kryhet çdo ditë vlerësim i personave të punësuar nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas checklistës së miratuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127.

* çdo punonjës është i detyruar të deklarojë nëse ka patur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.

* çdo punonjës që vëren shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqitet në punë. Punonjësi duhet të telefonojë 127 dhe mjekun e familjes.

* Personeli i punësuar duhet të përdorë në çdo moment dorezat mbrojtëse. Dorezat ndërrohen çdo ditë.

* Personeli i punësuar duhet të mbajë në çdo moment maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën. Maska ndërrohet çdo 3 ditë. Maskat mund të jenë edhe prej cope dhe në këtë rast duhet të ndërrohen çdo ditë.

* Të sigurohen maskat, higjenizuesi dhe dorezat.

* Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik midis punonjësve apo mes palëve të treta furnizues, shpërndarës etj., përfshirë përshtëset.

* Personat e tretë si furnizuesit, shpërndarësit të lejohen vetëm të pajisur me maska dhe doreza mbrojtëse dhe pas dezinfektimit të duarve.

* Gjatë pushimit apo orarit të ngrënies të shmanget grumbullimi i personave si në ambientet e shoqërisë ashtu edhe në ambiente publike.

Adresa: Rruga “Llazar Gjermwni” 01840037; Nd81; H.1; Kolonjw; Gorre; 9019; Lushnje.

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

- * Punonjësit gjatë punës nuk duhet të përdorin mjetet apo vendin e punës së kolegëve pa kryer dezinfektimin.
- * Klienti dezinfekton duart në hyrje dhe dalje nga dyqani. Klienti mban dorezat dhe maskën mbrojtëse çdo moment.
- * Të garantohet dhe respektohet në çdo moment distanca prej 2 metra midis klientit dhe personelit të punësuar.
- * Kollitja dhe tështitja kryhen duke përdorur brylin apo letër hundësh. Letra hidhet menjëherë në kosh. * Punonjësi kur kthehet në banesën e tij heq maskën dhe dorezat dhe lan duart e fytyrën për 20 sekonda me ujë dhe sapun. Dorezat dhe maska sipas rastit hidhen në kosh të mbyllur.
- * Punonjësit duhet të nxjerrin rrobat dhe uniformat e tyre në diell dhe ajrim pasi kthehen në banesë. Rrobat dhe uniformat duhet të lahen çdo 2-3 ditë.
- * Pas veprimeve me cash/karta krediti punonjësi dezinfekton duart me higjenizues.
- * Do të shërbehet vetëm një klient në ambient, ndërkohë që të tjerët presin jashtë në rradhë me distancë 2 metra nga njëri-tjetri.
- * Përdorimi i kondicionerit për ngrohje-ftohje të kryhet vetëm për 20 minura në çdo 1 orë.
- * Të vendosen shenjat përkatëse në formë rrathi të pritjes në rradhë jashtë ambienteve të njësive tregtare.
- * Të afishohen në një vend të dukshëm në fasadë, mundësia e shwrbimit online, mundësia e rezervimit të takimit online apo me telefon.
- * Të vendoset xham mbrojtës (ose pexiglass) klient shitës dhe shirit distance në banakun e arkës.
* Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik shitës-klient.
- * Të kryhet dezinfektim i ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes, sidomos i tavolinave, banaqeve, telefonave dhe çdo hapësirë ku ka patur kontakt prekje.
- * Të sigurohet ajrim sipas mundësisë minimalisht 3 herë në ditë.
- * Të afishohet lista e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.
- * Të afishohet posteri informues mbi uljen e riskut të COVID-19 sipas formatit të miratuar.
- * Të afishohet protokolli jeshil sipas tekstit të miratuar.
- * Të afishohet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga klientët dhe personeli i punësuar, sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.

PROTOKOLLI I VERDHË I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19 SHËRBIME NË SPORTEL

Adresa: Rruga “Llazar Gjermwni” 01840037; Nd81; H.1; Kolonjw; Gorre; 9019; Lushnje.

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

- Drejtuesi i njësisë së shërbimit kryen çdo ditë vlerësimin për prezencën e simptomave të COVID-19 në personat e punësuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127. Nëse personi shfaq simptoma ndërkokë që është duke punuar apo pas punës, ky person duhet të karantinohet nëse ekziston mundësia në një ambient të veçuar të objektit derisa të merren masat përkatëse nga shërbimet shëndetësore.
- Për çdo rast drejtuesi i njësisë së shërbimit lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutin e Shëndetit Publik.
- Drejtuesi i njësisë së shërbimit, ose një person i caktuar me urdhër mat temperaturën e punonjësve dhe të çdo personi tjetër shërbim marrës në hyrje dhe dalje me termometër infrared dhe njofton menjëherë strukturat përkatëse për temperaturat më të larta se 37,5 gradë në rastet kur ka edhe simptoma të tjera të COVID-19. Asnjë person me temp 37,5 nuk duhet të lejohet të hyjë në subjekt.
- Pavarësisht sa më sipër, personat e punësuar kryejnë çdo ditë vetëvlerësimin personal nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas checklistës së miratuar. Në rast të simptomave personi duhet të njoftojë menjëherë 127 dhe drejtuesin e njësisë së shërbimit.
- Çdo punonjës është i detyruar të deklarojë ndaj drejtuesit të njësisë nëse ka patur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.
- Çdo punonjës që vëren shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqitet në punë dhe duhet të lajmërojë menjëherë drejtuesin e njësisë së shërbimit. Punonjësi duhet të telefonojë 127 dhe mjekun e familjes.
- Kompania lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar nga dispozitat ligjore. ambient vetëm të boshatisur kundrejt mbajtjes së maskës dhe dorezave mbrojtëse.
- Kompania vendos xham mbrojtës (plexiglass) midis punonjësit dhe klientit.
- Në çdo rast të sigurohet ventilim (ajrimi) natyral të paktën 5 herë në ditë. Kompania të marrë masat përkatëse për ndërhyrje në sistemet e ventilimit ku të kalohet në modalitetin e ajrit natyral apo përmes shtimit të dritareve.
- Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik mes punonjësve apo mes palëve të treta përfshirë përshtëndetjet. Sipërfaqet e papastralihen fillimi me ujë dhe sapun e më pas dezinfektohen me produktet e tjera. Secili punonjës kryen dezinfektimin me produktet e higjenës të tavolinave, telefonave, kompjuterave, dhe çdo hapësire apo objekti ku ka patur kontakt prekje në fillim dhe përfundim të turnit. Produktet përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse nga prodhuesi/shitësi apo Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Punonjësit gjatë punës nuk duhet të përdorin mjetet apo vendin e punës së kolegëve pa kryer dezinfektimin. Kompania duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.

Adresa: Rruga “Llazar Gjermwni” 01840037; Nd81; H.1; Kolonjw; Gorre; 9019; Lushnje.

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE COVID-19

- Kompania duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19 sipas formatit të miratuar.
- Kompania duhet të afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit të verdhë njësi shërbimi, sipas formatit të miratuar ku përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/administratori/çdo person tjeter palë e tretë që hyn e del në ambientet e brendshme sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.
- Subjekti të afishojë të plotë protokollin e verdhë njësi shërbimi sipas tekstit të miratuar.
- Materialet e mësipërme afishohen në hyrje të subjektit si dhe në vende të dukshme në brendësi të njësisë.

Adresa: Rruga “Llazar Gjermwni” 01840037; Nd81; H.1; Kolonjw; Gorre; 9019; Lushnje.